

VENDIM
Nr.855, datë 13.12.2006

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
INFRASTRUKTURËS PORTUALE NË PORTIN E DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i infrastrukturës portuale në portin e Durrësit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Portual, Durrës.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, të paraqitur në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 7 303 m², tokë truall, e vlerësuar me 3 000 lekë/ m², në shumën e përgjithshme 21 909 000 (njëzet e një milionë e nëntëqind e nëntë mijë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 21 909 000 (njëzet e një milionë e nëntëqind e nëntë mijë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Autoritetit Portual, Durrës.
 5. Shpenzimet procedurale, në shumën 185 500 (njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Autoriteti Portual, Durrës.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda vitit 2006.
 7. Likuidimi i pronarëve nga Autoriteti Portual të bëhet brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Autoriteti Portual, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I
INFRASTRUKTURËS PORTUALE NË PORTIN E DURRËSIT

Nr.	Emri	Pasuria	Zona kadastrale	Sipërfaqja	Çmimi në lekë për m²	Vlera në lekë
1	Bashkëpronarët Krisanthi Qirko Spiro Qirko Margarita Qirko Mukades Kapshtica Sanije Kapshtica Viktoria Kraja Nadia Kapshtica Ana Veizi	NR.7/51 7/52	8514	3 703 m ²	3000	11 109 000
2.	Bashkëpronarët Rudolf Lara	NR.6/108	8514	3 600 m ²	3000	10 800 000

	Kozma Lara Vangjel Lara Veronika Lara Sotireta Lara Dhimitër Lara					
	SHUMA			7 303 m²		21 909 000

Vlera totale e shpronësimit është 21 909 000 lekë.